



TV Dukagjini
Ekrem Lluka
Drejtør
Pejë

Ankesa Nr. 2014/89 KPM vs TV Dukagjini
Ref:1506/735/LEG/as

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2014/89 – Komisioni i Pavarur i Media (KPM) kundër TV Dukagjini (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur me licencë të KPM me datën 28 gusht 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës, obligon të Licencuarin të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. KPM, me datën 28 maj 2013, ka miratuar Rregulloren për të Drejtën e Autorit KPM-2013/02. Me këtë rregullore janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e shërbimeve mediale audio-vizuale lidhur me respektimin e të drejtës së transmetimit dhe ritransmetimit.
3. KPM, qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Rregulloren për të Drejtën e Autorit KPM-2013/02, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse nga data 10 deri me 12 prill 2014. Gjatë monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar filma, për të cilët nuk ka siguruar kopje të kontratake për të drejtën autoriale. Filmat e gjetur janë: “From Paris with Love”, “De Javu”, “The Prince of Egypt”, “Land of the Lost”, “Blue Streak”, “Contraband”, “Beyond Borders”, “Song of the Songs”, “Caroline”, “Crimson Tide”, “The Sentine”, “Green Zone”, “Drive Angry”, “Kiss of the Dragon”, “Rango”, “A Dog Year”, “The Hang Over”.
4. KPM, duke u bazuar në raportin e monitorimit me datën 29 prill 2014, i ka dërguar Palës Përgjegjëse një kërkesë, që në afat prej pesë (5) ditësh t'i sjellin kopjet e kontratake valide për të drejtën e autorit, që dëshmon se e kanë të drejtën e transmetimit të filmave.
5. KPM, me datën 5 maj 2014 ka pranuar një përgjigje në mënyrë elektronike nga Pala Përgjegjëse, dhe mossjelljen e kontratake e justifikon me blerjen e filmave të caktuar dhe

mosarritjen që të pajisen me kontrata të nevojshme, duke mos e kontestuar transmetimin e filmave pa marrëveshje për të drejtën e transmetimit.

6. KPM, bazuar në shkeljen e vazhdueshme të Rregullores KPM-2013/02, nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 14 maj 2014 Palës Përgjegjëse i ka dërguar Njoftim për Shkelje, me të cilin ka kërkuar që të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/02, në të kundërtën KPM do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse për shkeljet e bëra.
7. KPM, edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje ka monitoruar Palën Përgjegjëse nga data 4 deri me 5 gusht 2014. Nga monitorimi është gjetur se Pala Përgjegjëse ka vazhduar të transmetojë filma pa siguruar marrëveshjet për të drejtat e autorit. Filmat tjerë të gjetur gjatë ditëve të monitorimit janë: "Evilenko", "Marvelles the Avengers", "Conan the Barbarian", "Paranormal Activity 3", "Miss Bala", "The Muppets", "Journey 2 Mysterious Island", "Salmon Fishing in the Yemen".
8. KPM, me datën 7 gusht 2014, ka kërkuar sërisht nga Pala Përgjegjëse që brenda afatit prej 5 ditësh t'i sjellë kopjet e kontratave për të drejtën e autorit, përmes të cilave dëshmon se ka të drejtën e transmetimit të filmave.
9. KPM, bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Rregullores KPM-2013/02 nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 4 shtator 2014, i ka dërguar Vërejtje për shkelje të nenit 4, paragrafi 1 dhe 2. KPM i ka tërhequr vërejtjen Palës Përgjegjëse se veprimi i mëtutjeshëm në kundërshtim me Rregulloren KPM-2013/02 do të rezultojë me masa sankzionuese në bazë të nenit 30 të Ligjit të KPM-së
10. KPM, edhe pas Vërejtjes se dërguar ka vazhduar me monitorimin e Palës Përgjegjëse, ku me datën 13 nëntor 2014, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Rregulloren KPM-2013/02.
11. KPM, me datën 17 nëntor 2014 ndërmori edhe hapin e fundit ndaj Palës përgjegjëse, duke i dërguar Urdhër për shkeljen e nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/02, duke e urdhëruar Palën Përgjegjëse që menjëherë të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/02, në të kundërtën KPM në bazë të nenit 30 të Ligjit të KPM-së, do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.

Analiza Ligjore

12. Komisioni, bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1 dhe 2, të Rregullores KPM-2013/02.

Nenit 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2013/02 "Detyrimet për të Drejtën e autorit", përcakton se:

"Të licencuarit i kërkohet të veprojë në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përaferta 04/L-065 si dhe ligjet tjera në zbatim në Republikën e Kosovës për pronësinë intelektuale, dhe në veçanti të sigurojë marrëveshje të vlefshme për të drejtën e autorit dhe leje për përdorimin veç e veç dhe në tërësi të të gjithë programeve komerciale. Këtu përfshihet riprodhimi, ritransmetimi dhe ritransmetimi i

njëkohshëm i sinjaleve të huaja dhe të importuara, qoftë nga emetues tokësorë të largët ashtu edhe nga sinjale dhe programe që rrjedhin nga sateliti. Në rastin kur programi konsiderohet i zotërimit publik, prodhimi i të cilit është më i vjetër se 70 vjet, nuk kërkohet një leje e tillë.”

Neni 4, paragrafi 2, i Rregullores KPM-2013/02 përcakton se:

“I Licencuari obligohet që t'i sigurojë KPM-së kopje të marrëveshjeve për këto të drejta brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i kërkesës me shkrim.”

13. Komisioni i KPM-së duke u bazuar në raportet e monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim të nenit 4, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores KPM-2013/02, pasi që në mënyrë të vazhdueshme ka bërë r/transmetimin e filmave pa të drejtë autoriale.
14. Bazuar në raportet e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të ardhur në pajtueshmëri me nenin 4, paragrafi 1 dhe 2, të Rregullores KPM-2013/02, duke transmetuar filma pa të drejtë autoriale.
15. Bazuar në raportet e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje, Vërejtjes dhe Urdhrit të dërguara nga KPM, përmes të cilave i është bërë me dije se është në shkelje të Rregullores KPM-2013/02, në mënyrë të vazhdueshme ka bërë transmetim të filmave pa të drejtë autoriale.
16. Komisioni i KPM-së bazuar në raportet e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të respektimit të Rregullores KPM-2013/02, prandaj Komisioni i KPM-së si rrëthanë renduese për Palën Përgjegjëse ka marr shkeljet e vazhdueshme të Rregullores KPM-2013/02, edhe pas kërkesave të KPM -së për të vepruar në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/02.
17. Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura Komisioni i KPM-së vlerëson se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores KPM-2013/02.

Vendimi


18. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores KPM-2013/02, pasi që në mënyrë të vazhdueshme ka bërë transmetimin e filmave pa të drejtë autoriale.
19. Komisioni, bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, sanksionon me Vërejtje Palën Përgjegjëse, për shkelje të vazhdueshme të nenit 4, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores KPM-2013/02, në rast se Pala Përgjegjëse vazhdon me të njejtat shkelje, KPM do të sanksionoj me gjobë Palën përgjegjëse.

E drejta për Ankesë

20. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
21. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



02.06.2015

datë